

INFORMACION MBI KONTRASTIN (i.v)

Egzaminimi i pacientit ne skaner mund te plotesohet, sipas diagnoses qe dyshohet, me berjen e kontrastit me ane te nje gjilpere ne vene (damar). Kontrasti duke qarkulluar ne gjak, arrin ne organe te ndryshme dhe jep efekt te rendesishem ne percaktimin e diagnozes.

Pra ndihmon ne:

Evidentimin e ndryshimeve imazherike te disa semundjeve qe nuk duken ne egzaminimin pa kontrast dhe karakterizimin e tyre.

Perdorimi i kontrastit eshte ne varesi te semundjes se dyshuar. Ashtu si dhe te gjithe medikamentet e tjere, edhe kontrasti mund te shkaktoje reaksione alergjike, ose mund te rendoje gjendjen e pacientit. Reaksioni mund te jete i nje shkalle te lehte deri ne te rende. Zakonisht me te prirur per reaksione te tille jane pacientet qe kane patur me pare reaksione nga medikamente te tjere (p.sh. penicilina), apo nga kontrasti intravenos qe eshte perdorur gjate egzaminimeve te tjera.

Kontrasti nuk shkakton reaksion me shpesh se medikamentet e tjere te perdorimit te perditshem, si (psh. penicilina), etj.

Nuk duhet te keni ngrene 3 ore perpara ekzammimit me kontrast intravenos.

SA SHPESH NDODHIN REAKSIONET E RENDA

Kercenimi i jetes nga perdorimi i kontrastit eshte shume i ralle.

Ne dhjetera mijera paciente te egzaminuar ne qendrat radiologjike te vendit tone, si dhe nga eksperiencia disavjecare e punes ne qendren tone, nuk eshte raportuar asnje rast i rende. Megjithate, gjate perdorimit te kontrastit ne qendren tone, do te jeni nen kujdesin maksimal te doktorit specialist reanimator.

Kontrasti qe perdoret ne kliniken tone eshte i prodhimeve me te mira, i njejte me kontrastin qe perdoret ne egzaminimet e tjera radiologjike si : pielografi, arteriografi, etj.

Per sa me siper eshte shenuar, kerkohet mirekuptimi i pacientit, ne rast se gjendja e tij e lejon, ose konfirmimi i familjareve qe e shoqerojne. Kontrasti nuk behet n.q.s refuzohet nga pacienti ose familjaret.